



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
**Asambleja**

Nr. 189 prot.

Tiranë, më 25 02.2020

## Rregullore

*Për çmimet shkencore që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe për mënyrën e organizimit të konkurseve të tyre*

### Neni 1 Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në Ligjin 53/2019 Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, neni 7 pika 8; në Statutin e saj, neni 25 pika 8, si dhe në përvojat pozitive të trashëguara.

### Neni 2 Qëllimi dhe objekti

Në këtë rregullore përkufizohen: 1. Llojet dhe mënyra e përcaktimit të çmimeve shkencore kombëtare e ndërkombëtare, si dhe të çmimeve të veçanta, që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej: ASHSH); 2. Kriteret e ngritjes dhe të funksionimit të jurive; kushtet e pranimit, të vlerësimit dhe të shpalljes së fituesve.

### Neni 3 Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. *Ligj është Ligji nr. 93/2019, datë 10.06.2019, Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë.*
2. *Çmime shkencore janë çmimet kombëtare, ndërkombëtare dhe ato të veçanta, që jepen nga ASHSH.*
3. *Nominim është përzgjedhja paraprake e veprave më cilësore për secilin nga çmimet shkencore nga juria.*
4. *Laureat është fituesi i cilitdo prej çmimeve.*

#### Neni 4

#### Qëllimi i çmimeve shkencore

##### 4.1. Çmimet shkencore që akordohen nga ASHSH kanë për qëllim:

- a. *Mbështetjen dhe vlerësimin e studimeve dhe kërkimeve shkencore më cilësore që realizohen brenda vendit në fushat përparësore të kërkimit shkencor akademik e universitar; si dhe të arritjeve më të rëndësishme që shenohen në albanologji nga studiuesit e huaj;*
- b. *Identifikimin e cilësisë dhe të origjinalitetit shkencor në kërkimin shkencor dhe nxitjen e konkurrencës;*
- c. *Orientimin e nxitjen e kërkimit shkencor në fusha dhe disiplina që kanë të bëjnë me çështje që diktohen prej zhvillimit të përgjithshëm të vendit;*
- ç. *Identifikimin dhe përrurimin e veprave që shërbejnë si modele të etikës në kërkimin shkencor;*
- d. *Nxitjen e ndërveprimit midis brezave të studiuesve, përmes vlerësimit të meritave jetësore të personaliteteve me karrierë të suksesshme akademike dhe promovimit të arritjeve më cilësore të studiuesve të rinj;*
- dh. *Mbështetjen e kërkimit institucional, prej shkallës së njësisë bazë deri tek projektet me karakter kombëtar e ndërkombëtar;*

##### 4.2. Konkursët shkencore organizohen me qëllim:

- a. *Nxitjen, promovimin dhe evidentimin e veprave e të arritjeve që ofrojnë zgjidhje me karakter jetësor për problematikat e zhvillimit të vendit, që kërkojnë mbështetje e zgjidhje prej mendimit shkencor;*
- b. *Funksionimin efektiv të urave të ndërveprimit midis vendimmarrjes politike dhe shkencës për çështje zhvillimore që duhet të asistohen prej kërkimit shkencor;*
- c. *Krijimin e një hapësire mbarëkombëtare për kompeticion shkencor;*

- ç. Ndikimin pozitiv për një ballafaqim e integrim të dijeve dhe kërkimeve në universitete, në institucione kërkimore jopublike, në qendra akademike;
- d. Rrjetëzimin funksional të dijeve në njësi, qendra dhe shkolla kërkimore të interesuara në dhe për botën shqiptare.

#### Neni 5

#### Çmimet shkencore kombëtare

ASHSH si rregull akordon çdo vit këto çmime shkencore kombëtare: çmimin e karrierës, çmimin për veprën më cilësore në shkencat shoqërore dhe albanologjike, si dhe atë për veprën më cilësore në shkencat teknike dhe natyrore.

#### Neni 6

#### Çmimi shkencor kombëtar në fushën e shkencave shoqërore-albanologjike

1. Çmimi shkencor kombëtar në fushën e shkencave shoqërore-albanologjike mban emrin e albanologut *Eqrem Çabej*. Ky çmim jepet për botime, projekte dhe për arritje të shquara akademike-universitare në fusha kërkimore përparësore të shkencave shoqërore-albanologjike.
2. Fituesit të çmimit *Çabej* i jepen simboli e diploma, që përmban: emrin e mbiemrin e tij, fushën e kërkimit shkencor, motivacionin, datën dhe vitin e lëshimit dhe numrin e amzës; si dhe një shpërblim.

#### Neni 7

#### Çmimi shkencor kombëtar në fushën e shkencave natyrore-teknike

1. Çmimi shkencor kombëtar në fushën e shkencave natyrore-teknike mban emrin e personalitetit të shquar *Petrit Radovicka* dhe jepet për botime, projekte e arritje cilësore akademike-universitare që u takojnë fushave përparësore të shkencave natyrore-teknike.
2. Fituesit të çmimit *Radovicka* i jepen simboli dhe diploma, që përmban: emrin dhe mbiemrin e tij, fushën e kërkimit shkencor, motivacionin, datën dhe vitin e lëshimit dhe numrin e amzës; si dhe një shpërblim.



#### Neni 8

#### Çmimi shkencor ndërkombëtar në albanologji

1. Çmimi shkencor ndërkombëtar në albanologji mban emrin *Trinia e Albanologjisë: Meyer-Pedersen-Jokli*. Ky çmim jepet periodikisht, por jo më rrallë se një herë në katër vjet, për vepra me rëndësi madhore të realizuara nga albanologë të huaj, që përforcojnë tezat themelore të dijeve për gjuhën, lashtësinë, vazhdimësinë, identitetin, trashëgiminë kulturore materiale e shpirtërore dhe historinë e shqiptarëve.

2. Fituesit të çmimit *Trinia e Albanologjisë: Meyer-Pedersen-Jokli* i jepen simboli dhe diploma, që përmban: emrin dhe mbiemrin e tij, fushën e kërkimit shkencor, motivacionin, datën dhe vitin e lëshimit dhe numrin e amzës; si dhe një shpërblim.

#### Neni 9

#### Çmimi shkencor kombëtar i karrierës akademike

1. Çmimi shkencor kombëtar i karrierës akademike jepet *për merita akademike-shkencore akademike* për personalitete të dijes, krijimtarisë dhe kulturës kombëtare, në shenjë nderimi për kontributet e tyre përgjatë jetës krijuese.

2. Ky çmim jepet vetëm një herë për të njëjtin personalitet.

3. Fituesit të çmimit të karrierës i jepen simboli dhe diploma, që përmban: emrin dhe mbiemrin e tij, fushat e kërkimit shkencor, motivacionin, datën dhe vitin e lëshimit dhe numrin e amzës; si dhe një shpërblim.

#### Neni 10

#### Çmimet e veçanta

ASHSH themelon, organizon konkurse dhe jep periodikisht çmime të veçanta, në kuadër të zhvillimit të kongreseve apo konferencave kombëtare a rajonale, me qëllim që:

1. Të vlerësojë ngjarje, personalitete dhe zhvillime historike-kulturore jubilarë;

2. Të nxisë me përparësi zhvillime të rëndësishme në shoqëri e shkencë;

3. Të promovojë fusha dhe nënfusha të veçanta kërkimi shkencor;
4. Të nxisë e promovojë kërkuesit e studiuesit e rinj.
5. Çmimi i veçantë për studiuesit e rinj më të suksesshëm mban emrin e dijetarit *Aleks Buda*, kryetar i ASHSH për dy dekada, prej themelimit.

#### Neni 11

##### Periodiciteti i çmimeve shkencore

1. Çmimet shkencore kombëtare të ASHSH si rregull janë të përvitshme. Konkurset për këto çmime zhvillohen jo më rrallë se në çdo dy vjet.
2. Shpallja e çmimeve të parashikuara qartësisht në këtë rregullore dhe për vitin e radhës dhe për hapësirën e konkurrimit për to bëhet me vendim të Kryesisë së ASHSH.
3. Themelimi dhe shpallja e çmimeve të veçanta miratohet me vendim nga Kryesia, me propozim nga Seksionet dhe/ose komisionet, vendim i cili i bëhet i njohur paraprakisht Asamblesë.

#### Neni 12

##### Pjesëmarrja në konkurs

1. Në konkurset vjetore për çmimet shkencore kombëtare dhe ato për çmimet të veçanta që jepen nga ASHSH mund të marrin pjesë:
  - Studiues nga Republika e Shqipërisë, nga gjithë hapësira historike shqiptare dhe nga diaspora;
  - Albanologë e shkencëtarë të huaj, me veprimtari të shquar aktive në shkencën shqiptare;
2. Kandidatët mund të propozohen nga institucionet kërkimore-shkencore ku kryejnë veprimtarinë e tyre, nga botuesit dhe shoqata shkencore ku janë të anëtarësuar. Kandidatët mund dhe të vetëpropozohen.
3. Për vepra me karakter institucional, propozues për pjesëmarrje mund të jenë: njësitë themelore të kërkimit shkencor, grupi i autorëve ose institucioni që ka mbështetur realizimin e saj.
4. Kandidimet pranohen për vepra me një autor dhe me shumë autorë, për vepra vetjake e institucionale. Në rastin e shpalljes fitues të një vepre shumautorëshe, shpërblimi i çmimit të fituar ndahet mes tyre.



5. Çmimet e veçanta si rregull jepen për studiues e vepra brenda vendit.

### Neni 13 Organizimi i konkurseve

1. Shpallja e konkurseve bëhet me *thirrje për pjesëmarrje* në faqen zyrtare të ASHSH dhe së paku *në tri medie kombëtare*.
2. Në konkurs pranohen vetëm punime shkencore që janë botuar në *vitin a dy vitet paraardhëse*. Konkurset për çmime të veçanta mund të jenë me karakter retrospektiv ose me parashpallje për një periudhë që mund të zgjasë deri në pesë vjet.
3. Shprehja e interesit për pjesëmarrje fillon nga dita e shpalljes dhe përfundon deri më 31 dhjetor të vitit në vazhdim.
4. Juria shpall listën e *plotë të konkurrentëve* jo më vonë se më 15 qershor.
5. Juria nominon nga numri i përgjithshëm i konkurrentëve jo më shumë se 3 (tre) kandidatë për çdo çmim.
6. Shpallja fituesve të çmimeve kombëtare dhe ceremonia për dhënien e tyre bëhet brenda muajit mars të vitit kalendarik vijues.
7. Për çmimet e veçanta kalendari i procedurave përcaktohet në vendimet përkatëse.

### Neni 14 Dokumentacioni për pjesëmarrje

Kandidati paraqet pranë ASHSH:

1. Kërkesën e motivuar për pjesëmarrje.
2. Deklaratën për pranimin e kushteve të konkurrimit
3. Curriculum vitae.
4. Listën e bashkautorëve dhe/ose përbërjen e redaksisë (për veprat me shumë autorë dhe nismat shkencore institucionale).
5. Dy kopje të studimit / projektit të botuar, të cilat pas konkursit hyjnë në inventarin e bibliotekës shkencore të ASHSH.
6. Certifikatën e regjistrimit të patentës; dëshminë e autoritetit miratues të projektit.

7. Deklaratën e autorësisë dhe të origjinalitetit të punës kërkimore shkencore/patentë.
8. Një përmbledhje analitike në gjuhën angleze për studimin e paraqitur për konkurrim.
9. Dy rekomandime prej institucionesh të specializuara kërkimore akademike-universitare janë të mirëpritura.
10. Kur çmimi i akordohet një institucioni, ai depoziton gjithashtu: aktin e themelimit, statutin, kopje të dokumentit si person ligjor, një deklaram të pranimit të çmimit.

#### Neni 15 Përbërja e jurisë

1. Juria formohet me anëtarë të brendshëm dhe të jashtëm. Anëtarët e jashtëm duhet të jenë më shumë se gjysma e përbërjes së saj.
2. Anëtarët e jashtëm propozohen nga institucionet universitare publike dhe jopublike dhe qendrat kërkimore-shkencore.
3. Në formimin e jurisë mbahen në vlerësim propozimet e studiuesve të huaj të botës shqiptare.
4. Organizatat shkencore ndërkombëtare në të cilat ASHSH është anëtare ose përfaqësohet (ALLEA, UAI, AIESEE, UNESCO etj.) ftohen të kenë përfaqësim në juri.
5. Anëtarët e jurisë nuk mund të konkurrojnë vetë në të njëjtin vit për çmimet kombëtare shkencore.
6. Përbërja nominale e jurisë shpallet me urdhër të Kryetarit të ASHSH.
7. Juria formohet vetëm për një konkurs, vetëm për një vit.
8. Juria ka sekretarinë e vet shkencore, e cila mban procesverbalet e mbledhjeve dhe të procedurave që kryhen prej saj. Në funksionin e sekretarit shkencor caktohet një punonjës i sektorit të botimeve dhe bibliotekës shkencore të institucionit. ASHSH krijon kushtet e nevojshme të punës për ushtrimin normal të përgjegjësisë të jurisë.
9. Vlerësimi dhe përzgjedhja e veprave të nominuara dhe fituese bazohet në indeksimin e njësuar ndërkombëtar dhe në standarde të gjithëpranuara për *ekscelencën shkencore*.



10. Për vlerësimin e veprave të paraqitura në konkurs juria mbështetet në kriteret e origjinalitetit, cilësisë shkencore, rëndësisë së veprës për dijen dhe në impaktin e saj intelektual e shoqëror.

11. Juria është autonome në vendimmarrje. Vendimet e jurisë merren me votim të fshehtë. Vota pakicë nuk komentohet publikisht. Kryetari i jurisë mund të paraqitet me komente publike, me pëlqimin e saj.

12. Jurisë i garantohet diskrecion i plotë për caktimin e vlerësuesve të jashtëm, oponentëve, ekspertizave të specializuara e recensionuesve.

13. Juria ka të drejtën e një shpërblimi për punën e saj, të përcaktuar me vendim të Kryesisë së ASHSH.

#### Neni 16 Konflikti i interesit

ASHSH përcakton si konflikt interesi çdo lidhje që do të ndërhynte ose do të mund të perceptohej si ndërhyrje në drejtësinë e vendimmarrjes.

Konflikti i interesit mund të jetë financiar, profesional apo personal, dhe mund të lindë përkundrejt një organizate apo një individi.

Nuk mund të jenë anëtarë jurie individët që kanë lidhje ndikuese për një vlerësim subjektiv dhe të pamërituar të veprës së paraqitur në konkurs: botues, redaktorë shkencorë e gjuhësorë dhe recensionues.

Anëtarët e jurisë deklarojnë menjëherë konfliktin e interesit dhe deklarojnë tërhiqen prej saj në momentin e shfaqjes.

Kur konflikti i interesit është i pavërtetueshëm, anëtari i jurisë mund të qendrojë në përbërje të saj, por pa të drejtë vote për rastin e përmendur.

#### Neni 17 Shpallja e fituesve

Shpallja e fituesve bëhet sipas nenit 10 të Rregullores për Ceremonialin.

#### Neni 18 Revokimi i çmimeve

1. Çmimet mund të revokohen kur provohet se është shkelur qartësisht etika e kërkimit shkencor dhe nuk janë respektuar të drejtat e autorit.



**Neni 19**  
**E drejta për informacion dhe ankimimi**

Pjesëmarrësi në konkurs ka të drejtën për t'u informuar për respektimin e procedurave gjatë regjistrimit, për zgjedhjes, nominimit dhe shpalljes së fituesve. Nuk përfshihet në këtë të drejtë mënyra e votimit të anëtarëve të jurisë dhe identifikimi nominal i mendimeve dhe komenteve të shprehura.


Pjesëmarrësi në konkurs ka të drejtën e ankimimit administrativ me shkrim pranë Kryesisë së ASHSH për shkelje të vërtetuara procedurale nga juria, që mund të kenë çuar në cenim të konkurrimit.


**Neni 20**  
**Amendimet**

1. Kjo rregullore mund të amendohet me vendim të Kryesisë së ASHSH, me propozim të seksioneve shkencore të saj ose të një të tretës së anëtarëve të Asamblesë.

**Neni 21**  
**Të fundme**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë, me publikimin në faqen zyrtare të ASHSH. Rregullorja e miratuar me urdhrin nr. 11 datë 6 tetor 2016 të Kryetarit të ASHSH shfuqizohet.

**Kryetari**  
  
**AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI**



Kjo rregullore u miratua në parim dhe në tërësi me vendimin nr. 18, në mbledhjen e datës 21 shkurt 2020 të Asamblesë së ASHSH.